

V E N D I M
Nr. 294, datë 24.6.1999

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 220, DATË 10.5.1999 «PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE DHE PËR TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE»

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 8421, datë 28.10.1998, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 10.5.1999 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, paragrafi i dytë ndryshon si vijon:

«Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në limitin organik të Ministrisë së Rendit Publik shtohen 214 punonjës».

2. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

«Për efekt të zbatimit të këtij vendimi, në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik, për vitin 1999, shtohen 71 500 000 (shtatëdhjetenjë milionë e pesëqind mijë) lekë, për pagat dhe sigurimet shoqërore, të cilat do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko